



Fjalorth

Yjet dhe Mjegullnajat

Disku mbledhës (Accretion Disk)

Një disk relativisht i sheshtë, prej gazi, pluhuri, gurësh etj, që i vjen rrotull një vrime të zezë, një ylli të porsalindur, ose ndonjë objekti masiv qendror. Disqet e mbledhjes rrotull yjeve pritët të përmbajnë grimca pluhuri, gurë etj, dhe mund të tregojnë prova të formimit aktiv të planetit. Beta Pictoris është një shembull i një ylli që dihet se ka një disk të mbledhjes.

Sistemi yjesh binar

Një sistem me dy yje që rrotullohen rreth një qendre të përbashkët të masës të cilët janë të lidhur së bashku nga tërheqja gravitacionale e tyre reciproke.

Yll blu

Një yll masiv dhe i nxehtë që duket me ngjyrë blu. “Spica” në konstelacionin Virgjëresha është një shembull i një ylli blu.

Xhuxh kaf

Një objekt shumë i vogël për të qenë një yll i zakonshëm sepse nuk mund të prodhojë energji të mjaftueshme nga bashkimi i atomeve në bërthamën e tij për të kompensuar energjinë rrezatuese që humbet nga sipërfaqja e tij. Një xhuxh kaf ka një masë deri në 0,08 në krahasim me masën e Diellit.

Variabli Cepheid

Një yll pulsues, drita dhe prodhimi i energjisë i të cilit ndryshojnë dukshëm gjatë një periudhe të caktuar kohe. Periudha kohore gjatë së cilës ylli ndryshon lidhet drejtpërdrejt me prodhimin e dritës ose shkëlqimin e tij, duke i bërë këta yje qirinj standardë të dobishëm për matjen e distancave ndërgalaktike.



Re e errët pluhuri

Re që përmban një përqendrim të pasur gazit dhe pluhuri në një rajon të hapësirës ndëryjore. Një re e tillë shpesh është në formë të parregullt, por nganjëherë ka konture të përcaktuara mirë. Drita e dukshme nuk mund të kalojë përmes këtyre reve, kështu që ato errësojnë dritën nga yjet pas tyre.

Mjegullnaja e gaztë

Një re e ndezur gazi në hapësirën ndëryjore. Reja e gazit mund të jetë ose një mjegullnajë emisioni, e cila thith dritën ultraviolett nga yjet pranë dhe rrezaton në dritën e dukshme, ose një mjegullnajë reflektimi, e cila reflekton dritën e yjeve të afërt me të, nga grimcat e saj të pluhurit.

Yll gjigand

Një yll që po vdes, që ka konsumuar karburantin e hidrogjenit në bërthamën e tij dhe ka filluar të zgjerohet. Yjet gjigantë kanë përgjithësisht një diametër shumë më të madh se Dielli ynë.

Grumbullim sferik

Një koleksion prej qindra mijëra yjeve të vjetër të mbajtur së bashku nga graviteti. Grumbujt sferik zakonisht kanë formë sferike dhe shpesh gjenden në rrotull galaktikave. Çdo yll që i përket një grumbulli sillet rreth qendrës së përbashkët të masës së grumbullit.

Diagrami Hertzsprung-Russell

Një grafik që tregon lidhjen midis shkëlqimit (ndriçimit) dhe temperaturave të sipërfaqes së yjeve. Shpesh klasa spektrale, e cila bazohet në temperaturën e yllit, përdoret si etiketë.

Pluhuri ndëryjor

Grimca të vogla të lëndës së ngurtë, të ngjashme me tymin, në hapësirën midis yjeve.



Lënda ndëryjore

Gazi i rrallë dhe pluhuri ndodhet midis yjeve të një galaktike.

Hapësira ndëryjore

Rajonet e errëta të hapësirës të vendosura midis yjeve.

Lakorja e dritës

Një grafik, që tregon se si drita që prodhon një yll (ose një objekt tjetër astronomik i ndryshueshëm) ndryshon në lidhje me kohën.

Re molekulare

Një rajon relativisht i dendur dhe i ftohtë i materies ndëryjore, ku gazi i hidrogjenit është kryesisht në formë molekulare. Yjet zakonisht formohen tek retë molekulare. Retë molekulare shfaqen si njolla të errëta në qiell sepse bllokojnë gati të gjithë dritën prapa tyre.

Ylli Neutronik

Një top jashtëzakonisht kompakt i neutroneve i krijuar nga bërthama qendrore e një ylli që u shemb nën gravitetin gjatë një shpërthimi të supernovës. Yjet neutronik janë jashtëzakonisht të dendur: ata janë vetëm 10 kilometra ose më shumë në madhësi, por kanë masën e një ylli mesatar (zakonisht rreth 1.5 herë më masiv se Dielli ynë). Një yll neutronik, që lëshon rregullisht impulse rrezatimi njihet si pulsar.

Nova

Një sistem binar ylli (i përbërë nga një xhuxh i bardhë dhe një yll shoqërues) që shkëlqen me shpejtësi, pastaj ngadalë zbehet në normalitet.

Ligji Periodë-Ndriçim

Një marrëdhënie që përshkruan se si shkëlqimi ose shkëlqimi absolut i një ylli të ndryshueshëm Cepheid varet nga periudha kohore gjatë së cilës ndryshon ai shkëlqim.



Mjegullnaja planetare

Një re në zgjerim prej gazi të ndezur e dëbuar nga një yll në fund të jetës së tij. Dielli ynë do të krijojë një mjegullnajë planetare në fund të jetës së tij.

Protostar

Një koleksion gazi dhe pluhuri ndëryjor tërheqja gravitacionale e së cilës po bën që ajo të shembet në vetvete dhe të formojë një yll.

Pulsar

Një yll neutronik, që lëshon impulse rrezatimi të shpejta dhe periodike.

Ylli Gjigand i Kuq

Një yll i vjetër, i ndritshëm, shumë më i madh dhe më i ftohtë se Dielli. Betelgeuse (alfa Orionis) është një shembull i një gjigandi të kuq.

Klasa Spektrale (Tipi Spektral)

Një skemë klasifikimi që grupon yjet sipas temperaturave të tyre sipërfaqësore dhe veçorive spektrale.

Vija Spektrale

Në një spektër, një emision (një shirit i ndritshëm) ose thithje (një shirit i errët) në një frekuencë ose gjatësi vale specifike.

Yll

Një top i madh gazi i mbajtur së bashku nga graviteti. Bërthama qendrore e një ylli është jashtëzakonisht e nxehtë dhe prodhon energji. Një pjesë e kësaj energjie çlirohet si dritë e dukshme, gjë që e bën yllin të shkëlqejë. Yjet vijnë në madhësi, ngjyra dhe temperatura të ndryshme. Dielli ynë, qendra e sistemit tonë diellor, është një yll i verdhë me temperaturë dhe madhësi mesatare.



Grumbull yjesh

Një grup yjesh të lindur pothuajse në të njëjtën kohë dhe vend, të aftë të qëndrojnë së bashku për miliarda vjet për shkak të gravitacionit të tyre të ndërsjellë.

“Starburst” për galaktikat

Një galaktikë që ka një ritëm jashtëzakonisht të lartë të formimit të yjeve. Këto galaktika përmbajnë yje masivë, në brendësi të tyre, së bashku me yjet e rinj që vëzhgojmë ne.

Evolucioni Yjor

Procesi i ndryshimit që ndodh gjatë jetës së një ylli nga lindja deri në vdekjen e tij.

Supernova

Vdekja shpërthyesë e një ylli masiv, prodhimi i energjisë i të cilës bën që gazrat e saj në zgjerim të shkëlqejnë për shumë javë ose muaj. Ajo që mbetet nga ky shpërthim është gazi dhe pluhuri i ndritshëm, i cili zgjerohet nga shpërthimi i yllit.

Mbetjet nga Supernova

Mbetjet e gazta që shkëlqejnë, dhe që janë në zgjerim, të një shpërthimi supernova.

Ylli T-Tauri

Një klasë yjesh shumë të rinj, të ndezur në prag të shndërrimit në yje normalë të ushqyer nga reaksionet termo-bërthamore në qendrën e tyre.

Ylli i ndryshueshëm

Një yll shkëlqimi (ndriçimi) i të cilit ndryshon me kohën.



Ylli Xhuxh i Bardhë

Mbetjet e nxehta dhe kompakte të një ylli me masë të vogël si Dielli ynë, tek i cili janë shteruar burimet e tij të karburantit për bashkimin termo-bërthamor. Xhuxhët e bardhë zakonisht kanë madhësinë e Tokës.

Marrë nga: <http://hubble.stsci.edu>